

Gjakovë-Arrestohen 10 persona për organizim të lojërave të fatit, Policia tregon çka sekuestroi



23/03/2025 09:01

f

t

l

Dhjetë persona janë arrestuar dje në Gjakovë, pasi që të njëjtit dyshohet se kanë kryer veprën penale “organizim i skemave piramidale”.

Arrestimi i tyre u bë pasi policia kishte pranuar informata të besueshme për organizimin e bixhozit të paligjshëm në një objekt banesor në qytetin e Gjakovës, ku janë kryer kontrole në dy lokacione të dyshuara.

Policia përmes raportit 24 orësh ka dhënë detaje tjera se çfarë është sekuestruar në dy lokacionet që janë kontrolluar.

“Gjatë kontrollit në dy lokacione janë gjetur dhe sekuestruar 3 aparate APEX, para të gatshme 5645 €, 250 franga Zvicerane, 140 \$, 90 pound, çipa të pokerit, dhe po ashtu në veturën e njërit nga të dyshuarit është gjetur e konfiskuar një revole”, thuhet në raportin e policisë.

Me vendim të prokurorit, të gjithë të dyshuarit pas intervistimit janë dërguar në mbajtje.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LuponMedia



Artikuj të ngjashëm



March 23, 2025
Këto janë masat e sigurisë para sfidës Shqipëri-Andorrë



March 23, 2025
“Muriqi magjik”, Memli Krasniqi uron promovimin e Kosovës në Grupin B...

LAJME TË FUNDIT

Këto janë masat e sigurisë para sfidës Shqipëri-Andorrë

“Muriqi magjik”, Memli Krasniqi uron promovimin e Kosovës...

Kosova në Ligën B të Kombeve, Ademi: Moment...

Viti 2024 në Kosovë me temperaturat më ekstreme të dekadës



Other Links